

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		08/06/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
06-	400/01-	21525	



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA DRENAS**  
**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

Në vështrim të nenit 68 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 dhe 17 të Ligjit nr.10/L-022 Për Banim Social dhe të Përballueshëm, Udhëzimit administrativ Nr.19/2010 për përmbajtjen e bonusit të banimit si dhe Programit Komunal Tre Vjeçar për Banim me Nr. 01/400/01-45971 dt.12.09.2023, Vendimit të Kuvendit Komunal me nr. 02-400/01-185720 dt. 30.04.2026, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall këtë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM PËR BONUS BANIMI**

Ftohen të gjithë qytetarët/familjet e Komunës së Drenasit në nevojë sociale për aplikim në **Programin e Bonus Banimit**, për subvencionimin e një pjese të qirasë së banesës në tregun e lirë. Bonusi i banimit është një formë e mbështetjes për familjet që nuk kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**Të drejtë për të përfituar nga ky program i banimit ka familja apo individi që;**

1. Është banor rezident i Komunës së Drenasit;
2. Nuk ka në pronësi apo në posedim njësi banimi, shtëpi individuale apo tjetër që i plotëson kushtet minimale të të jetuarit, bazuar në standardet dhe normat e ndërtimit dhe banimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
3. Ka mbetur ose rrezikon të mbetet pa e zgjidhur çështjen e banimit si rezultat i një (1) ose më shumë faktorëve në vijim:
4. Dëmtimit të ndërtesës që nuk i plotëson kushtet për të qenë njësi banimi, rrezikut të shkatërrimit për shkak të vjetërsisë së saj, zhvendosjes për shkak të investimeve publike apo për shkak të prishjes së ndërtesës që nuk i plotëson kushtet për t'u legalizuar;
5. Pamundësisë së pagesës së qirasë me kushtet e tregut;
6. Familje apo individ pa përkujdesje;
7. Fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të shkaktuara nga njeriu;
8. Dëmtimit të shtëpisë individuale, njësisë së banimit gjatë luftës së vitit 1998/1999
9. Të ardhurat e familjes apo individit, janë të pamjaftueshme për të përballuar koston e banimit sipas kriterëve të caktuara në nenin 9 të ligjit Nr.10/L-22.
10. Familja apo individi i plotëson kriteret tjera për të përfituar nga ndonjëri prej programeve të banimit social, sipas thirrjes publike dhe kriterëve të këtij ligji dhe rrethanave tjera të cilat komisioni i konsideronë relevante në kontekstin lokal.

Përfitues nga kjo thirrje do të jenë deri në pesë (5) familje, të cilat i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara në thirrjen publike dhe ligjet në fuqi.

## **E drejta e përparësisë**

E drejta e përparësisë për të përfituar nga programet e banimit caktohet sipas numrit të pikëve të fituara për secilin kriter të përcaktuar me ligj

1. Përbërja e familjes;
2. Kushtet aktuale të banimit;
3. Gjendja sociale-ekonomike e vlerësuar sipas kategorive të të ardhurave, të përcaktuara në nenin 9 të ligjit Nr.10/L-22.

## **Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për Bonus Banim, përfshijnë:**

1. Aplikacioni ( të dhënat e hollësishme)
2. Dokumenti identifikues (Leternjoftimi kopje për parashtruesin e kërkesës);
3. Deklarata e bashkësisë familjare;
4. Çertifikat apo Vertetim që nuk posedon tokë të palujtshme;
5. Vertetim nga Qendra për Punë Sociale për gjendjen ekonomike;
6. Vendim mbi shkallën e invaliditetit/ gjendja shëndetësore;
7. Të dhënat mbi gjendjen shëndetësore të parashtruesit të kërkesës, apo anëtarve të familjës;
8. Vërtetim nga Qendra e Punësimit për të gjithë anëtarët e familjes të papunë, mbi moshen madhore 18 vjeqare;
9. Dokument mbi të ardhurat mujore.
10. Kontratën me qiradhënesin.

## **Dokumente të tjera shtesë nëse kërkohen nga Komisioni Vlerësues;**

1. Çertifikata e Vendbanimit;
2. Konfirmimi i llogarisë bankare.

**Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë një vjeqare**, me mundësi rishqyrtimi qdo vit kalendarik nga organi kompetent komunal. Marrëdhëniet në mes të pronarit të banesës dhe përfituesit të bonusit rregullohen me kontratë.

**Niveli maksimal i qirasë** nuk duhet të kalojë shumën prej 200 Euro, ndërsa vlera e bonusit të banimit nuk mund të jetë më e madhe se pesëdhjetë përqind (50%) e qirasë minimale të banesave në tregun e lirë për komunën tonë.

Përveq rasteve të familjeve që në përbërjen e tyre kanë një person me aftësi të kufizuar, apo e ndonje sëmundje të rëndë kronike, si dhe raste të tjera, mund të subvencionohet me vlerë më të lartë të bonusit së sa vlera e përcaktuar.

Bonusi i Banimit jepet nga komisioni i caktuar për qështje të Banimit të Përkohshëm Social, ndërsa lidhja e kontratës bëhet në mes të personit fizik apo juridik, përkatësisht pronarit të njesisë banesore që jepet me qira dhe bartësit të së drejtës së banimit, përkatësisht qiramarrësit, përmes organit kompetent komunal.

**Mënyra e pagesës së bonusit:**

Shuma mujore e bonusit të banimit paguhet nga buxheti komunal në xhirollogarinë bankare të qiradhënësit ( 100 Euro, apo 50% e nivelit maksimal të qirasë së lartpërmendur).

Në rast të mospagesës së pjesës së qirasë nga ana e qiramarrësit, qiradhënësi është i detyruar t'ia kthej komunës pjesën e paguar të qirasë së pashfrytëzuar në rast të zgjedhjes së kontratës si pasojë e mospagesës së pjesës së qirasë nga ana e qiramarrësit.

**Marrja e aplikacioneve** mund të bëhet në ndërtesën e Komunës kati I në Qendren për Shërbime me Qytetar nr.11, 12 dhe dorëzohen në të njëjtën Zyre.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të shqyrtohen.

**Afati për aplikim** është 15 ditë pune, nga data 08.06.2026 deri me datë 26.06.2025

Pas përfundimit të afatit (prej 15 ditësh), Komisioni bënë vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve si dhe shpall listën përfundimtare të përfituesve.



**KRYETARI I KOMUNËS**  
*[Signature]*  
**RAMIZ LLADROVCI**